



REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJAKOVËS
OPSTINA DJAKOVICA/ MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit

Nr.07/351/01-14435

Dt.13.06.2017

Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit duke vendosur sipas kërkesës së aplikuesit: **Qemajl (Rasim) Rizvanolli** nga Gjakova, për dhënien e Lejes Ndërtimore për ndërtimin – ngritjen e katit mbi përdhesen ekzistuese të objektit të banimit individual, në kompleksin "Çarshija e Madhe" Gjakovë, me etazhitet KATI I-rë, në bazë të Ligjit për Ndërtim, Nr. 04/L-110, nenet 14, 15, 19, 20 dhe 21, si dhe Ligjit për Procedurën Administrative Nr 02/L-28 nenit 11, bien këtë:

AKTVENDIM

I. I LEJOHET aplikuesit: Qemajl (Rasim) Rizvanolli nga Gjakova, ndërtimi – ngritja e katit në objektin ekzistues të banimit individual, në kompleksin "Çarshija e Madhe" – Gjakovë, sipas Projektit Kryesor të prezantuar, të aprovuar nga Instituti për Mbrojtjen e Monumenteve të Kulturës në Gjakovë dhe nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit e Republikës së Kosovës sipas Vendimit Nr. 33/2017, datë 08.05.2017, Kushtet Ndërtimore me nr. 27/2017, të datës 17.03.2017, të lëshuar nga QRTK-MKRS-RKS, në ngastrën kadastrale ndërtimore me nr. 1664, ZK: Gjakovë - Qytet, në pronësi të të lartëpërmendurit, cila shtrihet në zonën e mbrojtur të trashëgimisë kulturore, përgjatë rrugës "Vëllëzërit Frashëri" me etazhitet të objektit Kati I-rë, dhe me sipërfaqe të përgjithshme të objektit për ndërtim $S = 122.84 \text{ m}^2$

Kati i parë: (Sip,Bruto): $S = 122.84 \text{ m}^2$

II. Pjesë përbërëse e këtij aktvendimi është:

- Vendimi me Nr. 33/2017 i datës 08.05.2017, mbi aprovimin e rekomandimit nga Komisioni për Shqyrtimin dhe Vlerësimin e Kërkesave dhe Projekteve Restauruese – Konservuese të Trashëgimisë Kulturore të Institutit të Kosovës për Mbrojtjen e Monumenteve "Miratimi i kërkesës për dhënien e kushteve për ndërtimin e objektit – shtëpi individuale për banim – pronar Qemajl Rizvanolli – Konuma Gjakovë, nga Instituti për Mbrojtjen e Monumenteve, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit e Republikës së Kosovës, dhe Kushtet Ndërtimore me nr. 27/2017, të datës 17.03.2017, të lëshuar nga QRTK-MKRS-RKS, në ngastrën kadastrale ndërtimore me nr. 1664, ZK: Gjakovë - Qytet;
- Situacioni i lokacionit me objektin sipas vijës rregullative dhe asaj ndërtimore e përshkruar në situacionin grafik i vërtetuar nga QRTK- Gjakovë, i cili është bazë për rilevimin gjeodezik të objektit nga pika 1 e këtij aktvendimi.

III . Hartimin e projektit për ndërtimin – ngritjen e katit në objektin ekzistues të banimit individual nga pika 1 e këtij aktvendimi e ka bërë ndërmarrja për ndërtim, projektim inxhiniering "ARCPROJECT" - Gjakovë.

IV. Investitori është i obliguar:

- Që të ruaj një ekzemplar original të dokumentacionit teknik në bazë të të cilit i është dhënë kjo Leje Ndërtimi;
- Që pa pëlqimin e hartuesit të projektit kryesor dhe pëlqimit të kësaj Drejtorie të mos bëjë asnjë ndryshim në projekt;
- Ta lajmërojë Drejtorinë e inspektionit për ditën e fillimit të punës së paku 8(tetë) ditë para fillimit të ndërtimit, me qëllim të verifikimit të fiksimit dhe piketimit të shtrirjes së objektit mbrenda lokacionit nga Drejtoria për Kadaster Gjeodezi dhe Pronë (të prezentohet procesverbali i inspektorëve);
- Të lejohen inspektorët e ndërtimit të verifikojnë gjatë ndërtimit ose në qdo kohë pas kryerjes të ndërtimit të objektit për të cilën është dhënë leja e ndërtimit se ndërtimi është kryer në bazë të lejes së ndërtimit dhe kushteve tekniko - urbanistike të dhëna nga QRTK;

V. Të njoftohet Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit me nga një kopje të Vendimit për mbikëqyrje profesionale të ekzekutimit të punimeve(për të gjitha fazat punimeve);

VI. Kjo leje ndërtimi vlenë 1(një) vite nga dita e lëshimit.

A r s y e t i m

Qemajl (Rasim) Rizvanolli nga Gjakova, me banim në rrugën “Vëllëzërit Frashëri” Nr.19, ka parashtruar kërkesën pranë DUMM me nr 07/351/01-14435, të datës 07.06.2017, për ndërtimin – ngritjen e katit mbi përdhesen ekzistuese të objektit të banimit individual, në kompleksin “Çarshija e Madhe”_Gjakovë, me etazhitet KATI I-rë, në ngastrën kadastrale ndërtimore me nr. 1664, ZK: Gjakovë - Qytet, në pronësi të të lartë përmendurit, cila shtrihet në zonën e mbrojtur të trashëgimisë kulturore, përgjatë rrugës “Vëllëzërit Frashëri” , siq është parashtruar dhe në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Duke pasur parasysh lokacionin e objektit i cili përfshihet në zonën me destinim të veçantë “Çarshinë e Madhe” e cila është zonë e mbrojtur e trashëgimisë kulturore, lënda i është përcjellur Qendrës Regjionale për Trashëgimi Kulturore në Gjakovë - IMMK – Gjakovë, rrespektivisht Komisionit për Trashëgimi Kulturore, pranë Institutit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore për dhënien e Pëlqimit në lokacion, për procedim të mëtutjeshëm, dhe bazuar në Vendimin me Nr. 33/2017 i datës 08.05.2017, mbi aprovimin e rekomandimit nga Komisioni për Shqyrtimin dhe Vlerësimin e Kërkesave dhe Projekteve Restauruese – Konservuese të Trashëgimisë Kulturore Konservuese të Trashëgimisë Kulturore të Institutit të Kosovës për Mbrojtjen e Monumenteve “Miratimi i kërkesës për dhënien e kushteve për ndërtimin e objektit – shtëpi individuale për banim – pronar Qemajl Rizvanolli – Konuma Gjakovë, nga Instituti për Mbrojtjen e Monumenteve, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit e Republikës së Kosovës, dhe Kushtet Ndërtimore me nr. 27/2017, të datës 17.03.2017, të lëshuar nga QRTK-MKRS-RKS, në ngastrën kadastrale ndërtimore me nr. 1664, ZK: Gjakovë – Qytet, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Së bashku me kërkesën investitori e ka paraqitë edhe këtë dokumentacion:

1. Planin e Situacionit në përpjesë 1:500 të datës 06.04.2016, të vërtetuar nga QRTK- Gjakovë
2. Kopjen e planit të datës 29.03.2017 me pronar Qemajl (Rasim) Rizvanolli lëshuar nga Drejtoria për Kadaster Gjeodezi dhe Pronë.
3. Çertifikatat mbi të drejtën në pronën e paluajtshme me numër të lëndës 1818/17, të datës 29.03.2017, të lëshuara nga Drejtoria për Kadaster Gjeodezi.
4. Kushtet Ndërtimore me nr. 27/2017, të datës 17.03.2017, të lëshuar nga QRTK-MKRS-RKS, në ngastrën kadastrale ndërtimore me nr. 1664, ZK: Gjakovë – Qytet.

5. Vendimi me Nr. 33/2017 i datës 08.05.2017, mbi aprovimin e rekomandimit nga Komisioni për Shqyrtimin dhe Vlerësimin e Kërkesave dhe Projekteve Restauruese – Konservuese të Trashëgimisë Kulturore të Institutit të Kosovës për Mbrojtjen e Monumenteve "Miratimi i kërkesës për dhënien e kushteve për ndërtimin e objektit – shtëpi individuale për banim – pronar Qemajl Rizvanolli – Komuna Gjakovë, nga Instituti për Mbrojtjen e Monumenteve, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit e Republikës së Kosovës.
6. Deklaratën Noteriale me nr. LRP.Nr. Rendor.1145/2017, dt.07.04.2017.
7. Vërtetimin mbi kryerjen e obligimeve nga tatimi ne prone me nr.430-a-1314, dt.30.03.2017.
8. Dëshminë mbi kryerjen e obligimeve nga taksa administrative dhe tarifa rregullative për rritjen e densitetit në Bankën Kombëtare Tregtare, filiali në Gjakovë me datë 09.06.2016.
9. Projektin kryesor (3 kopje) punuar ndërmarrja për ndërtim, projektim inxhiniering "ARCPROJECT" - Gjakovë.

Taksa administrative dhe tarifa rregullative për rritjen e densitetit është paguar në vlerën prej 587.60 Euro.


KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktvendimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afatin prej 30 ditësh, duke e llogaritur ditën e marrjes në dorëzim. Ankesa i parashtrohet Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor në Prishtinë, dhe e njëjta dorëzohet nëpërmjet kësaj Drejtorie.


Aktvendimi i dorzohet:

- Investitorit,
- Drejtorisë së Inspektionit ,
- Arhivës.

Zyrtar i lartë për çështje juridike


Zenel Shabani, jur.dipl.

U.D. Drejtori,



Elida Bejtullahu, inxh.e dipl.e ark

K.K. GJAKOVË

Zona. kadastrale : Gj.Qytet

Parc. nr.1664-4

PLAN SITUACIONI



Lejohet ngritja e katit te shtepise individuale mbi
Perdhesen egzistues e sipas vendimit ne.33/2017
te dates 08.05.2017 te leshuar nga MKRS-IKMM
Prishtine.

— Gjendja Kadastrale
— Gjendja Faktike

Gjakove, 31.05.2017



Drejtori MKRS-ORTK

Ark. Osman Goxani kons.rest.






Endi Komunës GJAKOVË
Shërbimi për Kadastër Gjeodezi dhe Pronë

KOPJE PLANI

Zona kad. GJAKOVË - QYTET

Shk. zvog. 1:

Poseduesi: RIZVANOLLI QEMAJL (RASIM)



Numri rendor i regjistrimit të taksave kadastrale: _____

Nr. Parcelës	Plani	Vendi i quajtur	Kultura	Klasa	Sipërfaqja			Vërejtjet
					Ha	a	m ²	
1664-4			OBORR			2	47	
			SHËTËPI			1	14	
Gjithësejtë						3	61	

Që kjo kopje e planit është besnike e origjinalit të vet sipas gjendjes në kadastër duke paguar taksën sipas vendimit të KK GJAKOVË.

Gjakovë 29.03 të vitit 2017

VËRTETON: